

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT
NDERMARRJA E SHERBIMEVE PUBLIKE, BASHKIA KORÇE

Date 13.06.2019

**Për: Shoqëri "LUAR Bros" SH.P.K me nr. NIPT L72322004M, Adresa: Tirane Tirane TIRANE
Bulevardi Gjergj Fishta, Qendra Alpas, Shkalla 2, Kati 2, Apartamenti nr.1**

Procedura e prokurimit: **"Shtylla metalike me ndricues"**

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-21782-05-13-2019**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: ***Kjo kontrate ka për qëllim blerjen e shtyllve metalike me ndricues.***

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët

Njoftojme se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

- 1. Shoqëria "NIKA" SH.P.K, NIPT J76705047U me vlerën:
900,000 (nënteqind mijë) leke.**
- 2. Shoqëria "DENISA BESHAI" P.F, NIPT L41904011K me vlerën:
945,000 (nënteqind e dyzet e pesë mijë) leke.**
- 3. Shoqëria "LUAR Bros" SH.P.K, NIPT L72322004M me vlerën:
962,500 (nënteqind e gjashtedhjet e dy mijë e pesëqind) leke.**
- 4. Shoqëria "VASKE GAQI" P.F, NIPT K33729014R me vlerën:
975,000 (nënteqind e shtatëdhjet e pesë mijë) leke.**

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Shoqëria "NIKA" SH.P.K, NIPT J76705047U për arsye se:

Operatori nuk plotëson kriteret e veçanta të kualifikimit të dokumenteve të tenderit, kapaciteti teknik, pika 3 sipas të cilit: "në rast se operatori ekonomik nuk është prodhues, duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi për furnizimin me ndriçues sipas objektit të prokurimit. Në rast se autorizimi do të lëshohet nga distributori ai duhet të shoqërohet me dokumentacionin që provon se është distributor i autorizuar për furnizimin me këto materiale".

Në dokumentacionin e paraqitur, shoqëria Nika sh.p.k ka paraqitur autorizim nga shoqëria Sali elektrik sh.p.k. e cila autorizon shoqërinë Nika se do të furnizojë me të gjitha sasi të shtyllave të kërkuara në procedurën e prokurimit në fjalë dhe se materialet do të jenë sipas specifikimeve teknike, por nuk është paraqitur dokument që të vërtetojë se kjo shoqëri është prodhuese e mallrave objekt i prokurimit apo distributor i autorizuar nga prodhuesi.

2. Shoqëria “DENISA BESHAJ” P.F, NIPT L41904011K per arsye se:

Operatori nuk plotëson kriteret e veçanta të kualifikimit të dokumenteve të tenderit, kapaciteti ekonomik dhe financiar, pika 2 sipas të cilit: “operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të certifikuara të balanceve të tre viteve të fundit (2018, 2017, 2016) të konfirmuara nga organi kompetent”.

Në dokumentacionin e paraqitur, Denisa Beshaj p.f nuk ka paraqitur kopje të certifikuar të bilancit të vitit 2018 në kundërshtim me kërkesat e dokumenteve të tenderit.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Shoqërinë “LUAR BROS” SH.P.K** se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **962,500 (nëntëqind e gjashtedhjet e dy mijë e pesëqind) leke pa TVSH** është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Nderrmarrjes se Sherbimeve Publike, Bashkisë Korçë** sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të së këtij njoftimi, por jo me vone se 5 dite nga kërkesa për lidhjen e kontratës.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të veprohet siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë : 05.06.2019

Ankesa: **Nuk ka**

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

ILIRJAN DINELLARI